



MENU

BREAKING NEWS

x

ULEN INFEKTIMET ME COVID-19 NE SHQIPERI, JA SA RASTE U SHENUAN GJATE 24 OR...

AKTUALITET

Policia finalizon mega-operacionin/ Godet “bahçen” e kanabisit në Kurbin, sekuestrohen armë, municione dhe drogë. Arrestohen 5 persona

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
2 PRILL 2019[Facebook](#)[WhatsApp](#)[Twitter](#)[Email](#)



Policia e Shtetit ka arrestuar sot 5 persona dhe ka shpallur dy në kërkim me akuzat se kultivimit të lëndëve narkotike në qytetin e Kurbin.

Operacioni është quajtur "Godull 2019", ka angazhuar drejtorinë vendore, forcat operacionale të policisë dhe FNSH.

Falë kësaj ndërhyrje janë sekuestruar 8 mijë kubik ku ishin fshehur farat e canabis sativa.

"Operacioni nga Komisariati i Policisë Kurbin, Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, Forca e Posaçme Operacionale në Policinë e Shtetit dhe FNSH-ja.

Sekuestrohen armë zjarri e municione luftarake, kubikë të porsa mbjellë me kanabis dhe lëndë narkotike kokainë. 5 persona në pranga dhe 2 në kërkim. Në zbatim të detyrave të përcaktuara në Planin e Veprimit, për marrjen e masave për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike, duke ushtruar kontroll periodik të territorit, si dhe bazuar në informacionet e marra në rrugë operative për disa shtetas që përgatiteshin për të kultivuar bimë narkotike në zonën e quajtur Godull, është organizuar dhe zhvilluar operacioni i koduar "Godull 2019".

Si rezultat i operacionit u arrestuan në flagrancë shtetasit:

- B. Sh., 39 vjeç, banues në Mamurras
- K. K., 59 vjeç, banues në Fushë Krujë
- K. Sh., 34 vjeç, banues në Mamurras

– Gj. N., 34 vjeç, banues në Lezhë

– V. Z., 41 vjeçe, banuese në Kurbin

Gjithashtu u shpallën në kërkim dy persona që po punohet intensivisht për kapjen e tyre.

Gjatë operacionit në territor në Godull Adriatik, në Njësinë Administrative Fushë Kuqe në Kurbin, u evidentuan kubikë të porsa mbjellë me fara kanabisi, si dhe sende të tjera që do të shërbenin për kultivim të bimëve narkotike.

Më cilësinë e provës materiale u sekuestruan:

-8000 kubikë ku ishin mbjellë fara kanabis sativa

– 5 doza të dyshuara lëndë e fortë narkotike kokainë

– 2 armë zjarri “pistoleta”

– 1 armë zjarri automatik

– 1 armë gjahu “shotgun”

– 680 fishekë , dylbi e thikë

Materialet procedurale në ngarkim të shtetasve të proceduar u referuan Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës Parë Kurbin për veprat penale “Kultivim i bimëve narkotike, kryer në bashkëpunim”, “Prodhim dhe shitje e lëndëve